



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije -- Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation

Datë: 27-09-2024
Nr. 5-2597

Komisioni për licencimin dhe rilicencim të BPrAL në Ministrin e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të dispozitave ligjore nga neni 11 paragrafi 3 dhe 4, dhe neni 14 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës nr. 04/L-037 në bazë të neneve 5, 6, 7 dhe 10 të Udhëzimit administrativ nr. 25/2012 për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë dhe Udhëzimit Administrativ nr. 17/2023 për ndryshimin dhe plotësimin e udhëzimit administrativ (MASHT) 25/2012 për licencimin e bartësve privat të Arsimit të Lartë në Kosovë, kërkesa nr. 2597 të datës 05.09.2024 të parashtruar nga BPrAL- Kolegji “Uni Universum” nxjerr:

V E N D I M
Për licencimin e Kolegjit “Uni Universum”

1. Bartësit Privat të Arsimit të Lartë / Kolegji “Uni Universum” kampusi kryesore, licencohet për periudhën 3 vjeçare (1 tetor 2024 - 30 shtator 2027), me këto programe të studimit:
 - 1.1. Nutricion dhe Fitnes BA Profesional, (vendimi nr. 1706/24 datë: 20.08.2024 të AKA-s)
 - 1.2. Juridik LLB (vendimi nr. 1516/24 datë: 05.08.2024 të AKA-s)
 - 1.3. Gjuhë Angleze BA; Shkenca Kompjuterike BSc; Siguri Kibernetike BA; Shkencë dhe Analizë e të Dhënave MSc (vendimi nr. 1085/24 datë: 30.05.2024 të AKA-s)
 - 1.4. Qeverisje dhe Siguri Kombëtare MA, (vendimi nr. 1705/24 datë: 20.08.2024 të AKA-s)
 - 1.5. Kozmetologji BA Profesional; Biomjeksi Laboratorike BSc; Dizajn Enterieri BA Profesional; Higjien Dentare BA Profesional; Dizajn Grafik BA Profesional; Gazetari Digjitale BA Profesional, (vendimi nr. 1765/24 datë: 28.08.2024 të AKA-s).
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Në mbështetje të dispozitave ligjore të cekura më lartë, komisioni për licencim dhe rilicencim të BPrAL/ Kolegjeve Private i Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, pas shqyrtimit të kërkesës nr. 2597 të datës 05.09.2024 komisioni vlerëson se parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kushtet dhe kriteret ligjore për licencim.

Licenca e këtij institucioni privat të arsimit të lartë zgjat tri vite akademike të programeve të studimit bazuar në vendimet e Agjencionit të Kosovës për Akreditim, pra për periudhën kohore nga data 1 tetor 2024 deri me 30 shtator 2027 si në dispozitiv të pika 1.

Komisioni për Licencim dhe rilicencim në MASHTI duke marrë parasysh faktet e ofruara nga ky institucion si dhe dokumentacionin e kompletuar për aplikim, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim, mund të parashtojë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi në Komisionin për ankesa të nëpunësve publik dhe ankesave të tjera në MASHTI.

Vendimi u dërgohet:

1. Kolegjit "Uni Universum";
2. Komisionit për licencim;
3. Sekretarit të përgjithshëm;
4. DALSHT;
5. Inspektoratit të Arsimit;
6. DNJBIA
7. Arkivit.



Kryetar i Komisionit

Burim Gashi